



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-25893/24 datë:19.09.2024



Npi – 01/307 datë: 25.09.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 25.09.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IX- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 25.09.2024 (e mërkurë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtori i DPUKGJ-së z.Grejtalb Emini, Drejtori i DBF-së z.Besnik Ahmeti, Asistentja e Kryesuesit znj.Gentiana Mehmeti, dhe nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 28.08.2024,
2. Plani-Buxhetor i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (pas diskutimit publik),
3. Raporti Periodik për zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023,
4. Propozim - Vendim për fshirjen e obligimeve Tatimore të AKP-së ndaj Komunës së Shtimes,
5. Propozim - Vendim për miratimin e shkallës tatimore progresive për vitin 2025,
6. Propozim-Vendim për ndarjen e parcelës për objektet e banimit të përballueshëm dhe social,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetj, pajtohem me pikat e rendit të ditës. Kur po flasim për KPF-në, në mbledhjen e kaluar nuk ka kaluar vendimi për formimin e dy drejtorive, dhe është shkelë rregullorja e punës së Kuvendit, prandaj ju sygjeroj që ta zbatoni rregulloren.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pika “Propozim-Vendim për miratimin e drejtorive komunale” ka kaluar në Kuvend si pikë shtesë, me propozimin që e ka bërë Kryetari.

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi rendin e ditës.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 28.08.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 28.08.2024.

Plani-Buxhetor i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Sot po e paraqesim Planin-Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2025, bazuar në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenin 61 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Sipas vendimit të Kuvendit Plani Buxhetor ka shkuar në diskutim publik dhe është mbajtur diskutimi publik. Materialin për këtë pikë e keni marrë dhe e keni lexuar, prandaj unë do të ndalem vetëm në pikat kryesore. Plani Buxhetor për vitin 2025 është planifikuar që të jetë gjithësejt 10,777,182 euro. Në vazhdim drejtori lexoi draftin me shifra sipas kodeve buxhetore. Nëse ka pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa: Faleminderit për prezantimin, ky draft Buxhet a e ka mundësinë që të ndryshohet, apo do të mbetet kështu qysh është.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Ne i kemi shtjerrë të gjitha mundësitë. Tash për me futë një projekt duhet me hjekë një tjetër me vlerën financiare të njejt.

z.Përparim Ramusa: Unë jamë “kundër” këtijë Buxheti, sepse nuk janë përfshi premtimet e Kryetarit, zotimet e ekzekutivit, dhe nuk janë përfshi kërkesat e qytetarëve, edhe pse ka me u diskutuar edhe në Kuvend.

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Faleminderit për prezantimin. Materialin e kemi marrë të hënën pas dite, dhe nuk kemi pas kohë të mjaftueshme për me përpunu, dhe për këtë arsye unë do të “abstenoj”. Kërkoj nga drejtori me na sqaruar më shumë ndarjet që janë bërë për pagat?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Nevoja ka qenë më e madhe te kodi buxhetor mallra dhe shërbime, në raport me kapitalet. Te pagat mirë jemi vetëm nëse ka ndryshim të koeficientit, atëherë Qeveria e ka për obligim që automatikisht me e mbulu ndryshimin.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje. Sa i përket Planit Buxhetor, unë e kamë një përvojë ku na tregon se gjithëherë më parë janë specifikuar projektet me rrugë e fshat, këtu janë të përgjithësuara, kështu që po përfshihen krejt fshatrat, kështu që kjo po më duket e pa arsyeshme. Unë psh. po du me ditë se sa ka investime në fshatin Petrovë e sa ka në fshatin Vojnovc.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Arsyetimi lidhur me specifikimin e projekteve te programi për investime kapitale është se nuk mundesh me i futë në rubrikën e projektit më shumë se 250 shkronja.

z.Përparim Ramusa: Puna e jote nuk është drejtor për me ardhur këtu e me ju thanë asambleistëve, pse nuk jeni ardhur në diskutim publik. Te numri rendor 4 ku janë paraparë 40.000 euro, ku aty janë përfshirë disa fshatra, banorët po duan ta dijnë se sa investime janë paraparë për fshatin e tyre e jo si tërsi e fshatrave.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Ne e kemi nesër një takim publik në fshatin Pjetërshticë e pas nesër e kemi Kuvendin. Qasja e juaj është e gabueshme, duhet me pas pak më shumë kujdes, sepse ne e dimë shumë mirë se qysh shkon kjo.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Ne kaq e kemi kulmin buxhetor., sepse me i pas edhe gjashtë milion ne ua kishim gjetur vendin. Sa i përket diskutimit publik ne i kemi procesverbalet për secilin projekt që është propozuar. Shumica e projekteve janë dy vjeqare e nuk mund të ndryshohen.

znj.Adelina Beqaj: Unë nuk po e kuptoj pse me u zvogëluar shuma te investimet kapitale. Arsyetimi i yt për mallra dhe shërbime është i kotë.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Pajtohem me juve që projekti me qenë i qartë dhe i saktë. Tye projektet e reja nëse nuk e ka emërtimin e fshatit, ajo veq mundet me qenë gabim teknik.

znj.Zejnije Velu: Përshëndetje. Buxheti duhet me u diskutu, po pajtohem, unë kam marrë pjesë në disa dëgjime publike dhe kamë marrë shënime. Lokalitetet secili i kanë pasë prioritetet e veta dhe i kanë përaqitur e shumica prej tyre edhe janë inkorporuar në Buxhetin e vitit 2025. Ne jemi “për” që ta votojmë dhe si KPF-ë i rekomandojmë Kuvendit për miratim.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” (Me votën e dyfishtë të Kryesuesit) me 3 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Planit Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2025.**

Pika 3

Raporti Periodik për zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Këtë pikë për zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023, e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar të Kuvendit, sepse e kemi edhe obligim ligjor. Siç e dini pra i kemi 8 rekomandime nga Zyra Kombëtare e Auditimit, prej tyre 5 rekomandime janë të përsëritura, ndërsa 3 rekomandime janë të reja. 6 të gjetura janë në process të zbatimit të tyre ndërsa 2 janë zbatuar. Materialin e keni marrë me kohë dhe besoj se e keni lexuar, prandaj edhe nuk do ta zgjati shumë prezantimin, por nëse ka pyetje do të përgjigjem.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit Periodik për zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023.**

Pika 4

Propozim - Vendim për fshirjen e obligimeve Tatimore të AKP-së ndaj Komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Ne nuk mund ti lëmë në pasqyrat financiare tona si obligime tatimore të pa shlyera për 10 ndërmarrje shoqërore të privatizuara nga AKP-ja, sepse kto obligime tatimore është dashur të kryhen qysh në vitin 2014 – 2015, kto obligime po na pasqyrohen edhe nga Auditori dhe po na reflektohen si të gjetura të tyre. Kjo e drejtë për ti kërkuar këto obligime tatimore tash më ka humbur siç e thash qysh heret, kur është dashur të kërkohej në kohën e privatizimit kur AKP-ja ka dhënë afat prej 45 ditësh që me i paraqit kërkesat ose ankesat e të gjithë pretendentëve ndaj këtyre ndërmarrjeve, por kjo nuk është bërë. Meqenëse ne këto 46,116.21 euro nuk mundemi me i arkëtuar më, ne kemi vendos ti propozojmë Kuvendit që të merr vendim për me i fshi këto borgje, dhe mos me u pasqyruar si të gjetura të Auditorit.

z.Përparim Ramusa; Nuk po e kuptoj logjikën pse ne me ja falë AKP-së këto 46 mië euro, që janë si obligime të AKP-së ndaj neve. Unë mendoj që jemi duke u ngutur, sepse unë jamë i mendimit se për këtë çështje duhet me vendosë Gjykata. Unë do të abstenoj në këtë pikë.

z.Kadri Emini; Unë jamë në ngjarje lidhur me këto borgje të AKP-së. Mendoj se është mirë me pa se a ka parshkrim absolut, sepse dëmi financiar nuk është i vogël, po bëhet fjalë për rreth 46 mijë euro.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për fshirjen e obligimeve Tatimore të AKP-së ndaj Komunës së Shtimes.**

Pika 5

Propozim - Vendim për miratimin e shkallës tatimore progresive për vitin 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Bazuar në Ligjin për Tatimin në Pronë ne si drejtori e kemi sjellë në Kuvend Propozim Vendimin për miratimin e shkallës tatimore progresive për vitin 2025. Këtë propozim e kemi bërë në minimumin e lejuar sipas vlerave të pronave duke filluar nga 0.10 % deri në 0.50% të vlerës së pronës në mënyrë progressive. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të prërgjigjem.

z.Përparim Ramusa: Unë mendoj se te kjo kështu siç është paraparë si tatim progresiv është gabim, sepse është ngarkesë e pa arsyeshme për qytetarin. Me këtë lloj të tatimit ne i detyrojmë bizneset me shku e me kaluar në formën e punës Jo formale, sepse ashtu kështu janë duke paguar më shumë. Kështu që unë jamë “kundër”.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për shkallën tatimore progresive për vitin 2025.**

Pika 6

Propozim-Vendim për ndarjen e parcelës për objektet e banimit të përballueshëm dhe social
Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, Komuna jonë është përfituese e këtij projekti për banim të përballueshëm dhe social, edhe pse ne nuk jemi ende nënshkrues të memorandumit. Ne e kemi propozuar këtë vendim për ndarjen e sipërfaqes prej 11052 m², (1 hektar, 10 ari e 52 metra) truell për ndërtimin e objekteve sipas projektit të Qeverisë të Republikës së Kosovës për Banim të Përballueshëm dhe Social, në Ngastrën Kadastrale, me numër: 03052-2, Zona Kadastrale – Shtime, Evidentuar në emër të “Komuna e Shtimes”. Projekti thirret 150X150 (150 muaj me nga 150 euro), dhe u dedikohet kryesisht qifteve të reja por jo vetëm për sa i përket banimit. Projekti ka qasje në rrugën kryesore për Ferizaj dhe do të fillojë me tri llamella.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pytje, cilat janë kriteret që duhet me i plotësuar qiftet e reja për të qenë përfitues në këtë projekt.

z.Përparim Ramusa: Vota e jonë si PDK-ë ka me shku “pro”. Me sa e di unë ne e kemi nda një parcelë në Lagjen e Pajtimit, dhe këto kriteret i plotëson edhe ajo. Unë po pyes se a duhet me e shfuqizuar atë vendim?

znj.Adelina Beqaj; A është ky vendim në përputhje me Planin Zhvillimor?

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Po është në përputhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndarjen e parcelës për objektet e banimit të përballueshëm dhe social.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk ka, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 11:42h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

